FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 31

Tiranë – E premte, 6 mars 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 5/2015 datë 12.2.2015	Për një ndryshim në ligjin nr. 9867, datë 31.1.2008, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër", të ndryshuar.....	1399
Ligj nr. 6/2015 datë 12.2.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"…	1399
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 2, datë 6.2.2015	Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale…	1402
Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nr. 5, datë 17.2.2015	Për të drejtat, detyrat, zgjedhjen dhe mandatin e anëtarëve të bordeve në qendrat publike të formimit profesional……	1404
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 9, datë 27.2.2015	Mbi marrëveshjet e çmimit në avancë……	1406
Udhëzim i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr.1283, datë 16.2.2015	Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në llogari të thesarit.....	1418
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 9, datë 25.2 2015	Për shpërndarjen e financimit për projektet në vazhdim për shëndetësinë, pjesë e fondit për zhvillimin e rajoneve për vitin 2015……	1419
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 13, datë 11.2.2015	Për licencimin e shoqërisë "Dragobia Energy" sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	1420
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 14, datë 11.2.2015	Mbi kërkesën e OST sh.a. për rishikimin dhe pezullimin e vendimit nr. 156, datë 1.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Për miratimin rregullave të ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO)".	1421

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 15, datë 11.2.2015	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë "GAEA-Energjia Alternative e Gjelbër" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	1421
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 16, datë 11.2.2015	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë "GAEA-Energjia Alternative e Gjelbër" sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	1422
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 17, datë 11.2.2015	Për licencimin e shoqërisë "Power Elektrik Sllabinje" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	1423
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 18, datë 11.2.2015	Për licencimin e shoqërisë "Power Elektrik Sllabinje" sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	1423
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 19, datë 11.2.2015	Për licencimin e shoqërisë "Hidropower Elektrik" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	1424
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 20, datë 11.2.2015	Për licencimin e shoqërisë "Hidropower Elektrik" sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	1425
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 21, datë 11.2.2015	Për licencimin e shoqërisë "Fatlum" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	1425
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 22, datë 11.2.2015	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë "Green Energy Trading Albania" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	1426
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 23, datë 11.2.2015	Për licencimin e shoqërisë "Future Energy AL" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	1426
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 24, datë 11.2.2015	Për licencimin e shoqërisë "Future Energy AL" sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	1427
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 25, datë 11.2.2015	Për licencimin e shoqërisë "Anio Oil & Gas" sh.a. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror për një afat 5-vjeçar.....	1428
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 26, datë 11.2.2015	Për miratimin e pagesës së aplikimit për licencë në sektorin e gazit natyror.....	1428
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 27, datë 16.2.2015	Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë, për vitin 2015, që do t'u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet.....	1429
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Leonard Sema.....	1429

LIGJ
Nr. 5/2015

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9867, DATË 31.1.2008, "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR TREGTIMIN NDËRKOMBËTAR TË LLOJEVE TË RREZIKUARA TË FAUNËS DHE TË FLORËS SË EGËR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9867, datë 31.1.2008, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër", të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Në nenin 14, "Kushtet për marrjen e lejes për import", në fund të pikës 1, fjalët "lëshohen nga autoriteti shkencor kur:" zëvendësohen me fjalët "lëshohen vetëm kur autoriteti shkencor:"..

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.02.2015.

Shpallur me dekretin nr. 8981 , datë 26.2. 2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 6/2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.10081, DATË 23.2.2009, "PËR LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Kudo në ligj, emërtimi "Regjistri Kombëtar i Licencave dhe Lejeve" zëvendësohet me emërtimin "Regjistri Kombëtar i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve".

Neni 2

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në nen, fjalët "licencë/leje" zëvendësohen me fjalët "licencë/autorizim/leje", në përputhje me rasën dhe trajtën e përdorur në kontekstin përkatës për çdo rast.

2. Në pikën 1, fjalët "hyn në fuqi vetëm pas publikimit të saj" zëvendësohen më fjalët "hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet".

3. Pika 7 shfuqizohet.

Neni 3

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 15
Kompetenca për trajtimin e licencave/autorizimeve/lejeve

1. Licencat dhe lejet, sipas fushave dhe kategorive, në kompetencë të institucioneve qendrore, parashikohen në shtojcën që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Fushat e autorizimeve, në kompetencë të institucioneve qendrore, janë të njëjtat me fushat për licencat dhe lejet, që parashikohen në shtojcën, që i bashkëlidhet këtij ligji.

2. Parashikimi i kategorive të tjera të licencave/autorizimeve/lejeve, në kompetencë të institucioneve qendrore, nga ato të paparashikuara në shtojcë, është i mundur vetëm nëpërmjet ndryshimit të kësaj shtojce.

3. Kërkesat për licencat dhe lejet e parashikuara në shtojcë apo nënkategoritë e tyre, si dhe për autorizimet, sipas fushave të parashikuara në shtojcë, apo kategoritë e nënkategoritë e tyre trajtohen:

a) si rregull, nga apo nëpërmjet QKL-së;

b) në raste të veçanta, nga organet e përcaktuara sipas legjislacionit përkatës në fuqi, pa përfshirjen e QKL-së.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës, përcakton:

a) nënkategori të licencave, autorizimeve e të lejeve, të parashikuara në shtojcë;

b) kategori dhe nënkategori të autorizimeve, sipas fushave të parashikuara në shtojcë;

c) licencat, autorizimet dhe lejet apo nënkategoritë e tyre, kërkesat për të cilat trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së, sipas kreut V të këtij ligji."

Neni 4

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë ndryshimet në të gjitha ligjet e tjera, në lidhje me autorizimet që lëshohen nga institucionet qendrore, për sigurimin e përputhshmërisë me këtë ligj, dhe t'ia paraqesë ato Kuvendit në trajtën e një pakete të vetme, si dhe të miratojë akte nënligjore në fushën e autorizimeve dhe të përshtasë aktet nënligjore në fuqi.

2. Ngarkohen Këshilli i Ministrave, ministri dhe ministri përgjegjës që, brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktet nënligjore të parashikuara në nenin 3 të tij.

3. Ngarkohen ministrat dhe organet e tjera që, brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë akte nënligjore në fushën e autorizimeve dhe të përshtatin aktet nënligjore në fuqi, në përputhje me parimet dhe dispozitat e këtij ligji.

Neni 5

Dispozita kalimtare

1. Ngarkohen të gjitha institucionet qendrore, që kanë lëshuar autorizime deri në afatin e parashikuar në pikën 3 të këtij neni e që, sipas këtij ligji, trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së, t'i dërgojnë QKL-së të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin që publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, brenda këtij afati.

2. Ngarkohen të gjitha institucionet e pavarura dhe institucionet qendrore, të përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 3, të nenit 15, të ligjit, të publikojnë, brenda datës 31.12.2015, në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e përcaktuar, sipas parashikimeve të këtij ligji për autorizimet e vlefshme e të dhëna prej tyre deri në këtë datë.

3. QKL-ja fillon trajtimin e autorizimeve, në përputhje me këtë ligj dhe kreun V të ligjit, jo më vonë se data 30.9.2015.

4. Institucionet qendrore kompetente për trajtimin e autorizimeve, sipas legjislacionit përkatës, përpara hyrjes në fuqi të kësaj dispozite, vazhdojnë të pranojnë kërkesa dhe t'i trajtojnë ato deri në datën e fillimit të trajtimit nga QKL-ja, sipas pikës 3 të këtij neni. Kërkesat në proces dhe të papërfunduara deri në këtë datë trajtohen nga institucionet përkatëse, në përputhje me procedurën e zbatuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç rastit kur kërkuesi tërheq kërkesën dhe vendos ta paraqesë atë pranë QKL-së.

Neni 6

Shtojca bashkëlidhur ligjit "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" zëvendësohet me shtojcën që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.02.2015.

Shpallur me dekretin nr. 8982 , datë 26.2.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

SHTOJCË

Nr.	Nr. i fushës/kategorisë	Lloji i kategorisë	Fusha/kategoritë e veprimtarive dhe/ose të të mirave publike e të përdorimeve të tyre
	Fusha I		Siguria kombëtare, rendi publik dhe mbrojtja civile
1	1.	Licencë	Prodhimin dhe/ose tregtimin i mallrave (armë, municione, lëndë, pajisje, teknologji etj.) ushtarake dhe/ose me përdorim të dyfishtë
2	2.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile
3	3.	Licencë	Shërbimi privat i sigurisë fizike
	Fusha II		Ushqimi dhe shëndeti
4	1.	Licencë	Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve
5	2.	Licencë	Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare
6	3	Licencë	Rritja ose tregtimi i kafshëve
7	4.	Licencë	Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve
8	5.	Licencë	Prodhimi dhe/ose tregtimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve
9	6.	Licencë	Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë
10	7.	Licencë	Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë
11	8.	Licencë	Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare
	Fusha III		Mjedisi dhe burime mjedisore bazë
12	1.	Leje	Për ndikimin në mjedis
13	2.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis
14	3.	Licencë	Importi i mbetjeve për qëllim riciklimi, përpunimi, dhe/ose përdorimi ose importi i substancave ozon-holluese
15	4.	Leje	Shfrytëzimi dhe/ose kultivimi i florës (tokësore dhe/ose ujore)
16	5.	Leje	Shfrytëzimi dhe/ose mbarështimi i faunës (tokësore ose ujore)
17	6.	Leje	Shfrytëzimi i ujërave mbi dhe/ose nën/tokësore dhe/ose baseneve e materialeve të tyre
18.	7	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë
	Fusha IV		Burime minerare, hidrokarbure dhe energjetike
19	1.	Leje	Minerare ose hidrokarbure
20	2.	Leje	Për të gjitha rastet që burojnë nga legjislacioni për koncesionet
21	3.	Leje	Rastet dhe llojet e tjera të përdorimit të burimeve me natyrë energjetike
22.	4.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet e kësaj fushe
	Fusha V		Territori dhe ndërtimi
23	1.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me zhvillim e territorit dhe/ose ndërtimin
24	2.	Leje	Zhvillimi territorial dhe/ose ndërtimor
	Fusha VI		Trashëgimia kulturore
25	1.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me trashëgiminë kulturore
26	3.	Leje	Restaurim dhe/ose rrjetëzimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore
27	4.	Licencë	Administrimi kolektiv i të drejtave të autorit
	Fusha VII		Transporti
28	1.	Licencë	Transport rrugor ndërkombëtar i udhëtarëve
29	2.	Licencë	Transport rrugor ndërkombëtar mallrash për të tretë
30	3.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor
31	4.	Licencë	Transport ndërkombëtar detar i automjeteve dhe/ose udhëtarëve

32	5.	Licencë	Për shërbime portuale
33	6.	Licencë	Për shërbime hekurudhore
34	7.	Licencë	Për shërbime aeroportuale
	Fusha VIII		Industri dhe shërbime të tjera
35	1.	Licencë	Prodhimi, depozitimi, transporti, përdorimi dhe/ose tregtimi i produkteve dhe/ose lëndëve a pajisjeve të tjera me rrezikshmëri
	Fusha IX		Arsimi dhe shkenca
36	1.	Licencë	Arsimi parauniversitar
37	2.	Licencë	Arsimi i lartë
	Fusha X		Kujdesi shoqëror dhe punësimi
38	1.	Licencë	Shërbime të kujdesit shoqëror
39	2.	Licencë	Shërbime të ndërmjetësimit në tregun e punës dhe/ose formimit profesional
	Fusha XI		Drejtësia dhe ligji
40	1.	Licencë	Shërbimi i Noterisë
41	2.	Licencë	Shërbimi i Përmbarimit
42	3.	Licencë	Shërbime të tjera ekspertize ose profesionale të lidhura me të drejtat civile dhe/ose penale
	Fusha XII		Financat publike
43	1.	Licencë	Për trajtime të favorizuara fiskale dhe/ose doganore
44	2.	Licencë	Shërbime ekspertize ose profesionale financiare apo shërbime të lidhura me financat publike
45	3.	Licencë	Organizimi i lojërave të fatit

UDHËZIM
Nr. 2, datë 6.2.2015

PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të nenit 13 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 8.2.2006 "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe provimet në shkollat e larta publike", të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)",

UDHËZOJMË:

1. Për vitin shkollor 2014-2015, lëndët e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale, për shkollat profesionale të jenë:

a) Provime të detyruara (D1; D2; D3):

- Gjuhë shqipe dhe letërsi;
- Matematikë;
- Gjuhë e huaj.

b) Provimi me zgjedhje të detyruar (Z1),

- Teori profesionale e integruar, sipas drejtimit/profilit përkatës.

c) Provimi me zgjedhje (Z2).

1.1 Testi i gjuhës së huaj (D3) të hartohet në përputhje me gjuhën, e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor B1.

1.2 Lista e gjuhëve të huaja që do të jepen si provim i detyruar D3, është:

- Anglisht,
- Italisht,
- Frëngjisht,
- Gjermanisht.

Gjuha e huaj që do të jepet provim, do të pasqyrohet në formularin A1/A1Z.

Kandidatët e vitit të kaluar, që rezultuan mbetës në D3, janë të detyruar ta rijapin këtë provim. Kandidatët e tjerë, që aplikojnë me A1Z, nuk do ta rijapin provimin e detyruar D3.

1.3 Testi i provimit të detyruar D3 (gjuhë e huaj) hartohet nga AKP-ja. Ky provim zhvillohet, vlerësohet dhe administrohet nga DAR/ZA-të.

1.4 Vlerësimi i gjuhës së huaj (D3), si provim i detyruar, do të pasqyrohet në certifikatën e Maturës Shtetërore Profesionale, por nuk do të ndikojë të pikët, sipas formulës së përcaktuar në pikën 8/b të këtij udhëzimi.

1.5 Provime me zgjedhje janë sipas lëndëve:

Nr.	Lënda	Kredite
I. Për të gjitha shkollat e mesme		
1.	Gjuhë e huaj	10
2.	Letërsi e thelluar	5
3.	Matematikë e thelluar	5
4.	Kimi bërthamë	4
5.	Kimi e thelluar	6
6.	Fizikë bërthamë	4
7.	Fizikë e thelluar	6
8.	Biologji bërthamë	4
9.	Biologji e thelluar	6
10.	Histori bërthamë	5
11.	Histori e thelluar	9
12.	Gjeografi bërthamë	5
13.	Gjeografi e thelluar	7
14.	Ekonomi bërthamë	2
15.	Ekonomi e thelluar	4
16.	Teknologji bërthamë	2
17.	Teknologji e thelluar	4
18.	Qytetari	3
19.	Psikologji	2
20.	Filozofi	2
21.	Sociologji	2
II.Vetëm për shkollat artistike		
20.	Histori muzike	6
21.	Histori arti	6
22.	Histori baleti	3
III.Vetëm për shkollat profesionale		
23.	Teori profesionale e integruar (me zgjedhje të detyruar)	8

1.6 Testi i gjuhës së huaj me zgjedhje do të hartohet në nivelin gjuhësor B2.

1.7 Lista e gjuhëve të huaja, si lëndë me zgjedhje, do të përcaktohet në udhëzimin për plotësimin e formularit A1/A1Z.

1.8 Programet orientuese të lëndëve të detyruara ("Letërsi dhe gjuhë shqipe", "Matematikë" dhe "Gjuhë e huaj") dhe të provimit me zgjedhje të detyruar ("Teori profesionale e integruar"), për të gjithë maturantët/kandidatët nga shkollat profesionale, të jenë në përshtatje me programet ekzistuese të shkollave profesionale.

1.9 Programet orientuese të lëndëve me zgjedhje, të jenë të njëjta për të gjithë maturantët/kandidatët që plotësojnë formularin A1/A1Z, përveç teorisë profesionale të integruar.

1.10 Programi orientues i një lënde të thelluar, të përmbajë edhe programin e lëndës bërthamë (përjashtuar lëndët e provimeve të detyruara).

1.11 Lënda "Gjeografi" (bërthamë dhe e thelluar) të përmbajë edhe lëndën "Shkenca e tokës".

1.12 Maturanti/kandidati nga shkolla profesionale ka të drejtë të zgjedhë një lëndë nga grupi i lëndëve "I. Për të gjitha shkollat e mesme" tek lista e lëndëve me zgjedhje, pavarësisht nëse e ka zhvilluar ose jo atë, i është ofruar apo jo nga shkolla në programin mësimor.

2. Maturanti/kandidati nga shkolla profesionale të zgjedhë dy lëndët për provimet me zgjedhje nga lista e lëndëve me zgjedhje (pika 1.5), sipas këtyre kritereve:

a) Lëndën e parë (Z1), me detyrim, teoria profesionale e integruar, nga grupi i lëndëve "III. Vetëm për shkollat profesionale";

b) lëndën e dytë (Z2) nga grupi i lëndëve "I. Për të gjitha shkollat e mesme".

3. Kandidatëve, të cilët kanë dhënë provime me zgjedhje dhe janë vlerësuar me notë të përshkallëzuar jo më të vogël se 4.50, (nota 5), u njihen ato provime.

4. Kandidatët të cilët nuk janë kalues ose nuk kanë dhënë provimet me zgjedhje, do t'i japin ato në përputhje me këtë udhëzim.

5. Kandidatët, të cilët janë kalues vetëm në njërin nga provimet me zgjedhje, ta mbartin atë dhe të japin një provim tjetër, në përputhje me këtë udhëzim.

6. Kandidatët, që në Maturën Shtetërore 2012 kanë zgjedhur për të dhënë 3 (tri) provime me zgjedhje dhe:

a) kanë mbetur në dy provime, të zgjedhin vetëm një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje të këtij udhëzimi;

b) rezultojnë kalues në dy prej tyre, pavarësisht nga shuma e krediteve, të pajisen me diplomën e maturës.

7. Kandidatëve, të cilët kanë marrë dëftesë pjekurie para vitit 2006 dhe dëshirojnë të aplikojnë për studime universitare, t'u njihen dy nga provimet e detyruara që përputhen me D1 dhe D2, ose provimet e njëvlershme me to, të njehsuara nga DAR/ZA-të.

8. Për llogaritjen e pikëve të procedohet si më poshtë:

a) Shënohen me:

- M, D1, D2, Z1 dhe Z2 përkatësisht pikët mesatare të arsimit të mesëm të lartë, vlerësimet në lëndët e detyruara "Letërsi dhe gjuhë shqipe", "Matematikë" dhe në ato me zgjedhje (ku: Z1 janë pikët në vlerësimin për "Teorinë profesionale të integruar").

- K, F1 dhe F2 përkatësisht koeficienti i shkollës dhe koeficientet e lëndëve me zgjedhje të përcaktuara nga universitetet publike.

b) Llogaritja e shumës S të pikëve të maturantëve/kandidatëve, të cilët kanë rezultuar kalues në provimet me detyrim dhe me zgjedhje, bëhet me formulën:

$S = \{[26 \times M + 20 \times (D1+D2)] \times K + 17 \times (Z1 \times F1 + Z2 \times F2)\} \times 5$

9. Provimi i Teorisë Profesionale të Nivelit të III, të Arsimit Profesional, që zhvillohej nga vetë shkollat profesionale, nuk do të zhvillohet më në vijim. Provimet e tjera të teorisë dhe të praktikës profesionale, në nivelin I dhe II dhe provimi i praktikës profesionale në nivelin III, do të zhvillohen nga shkollat profesionale, si edhe më parë.

10. Për realizimin e Maturës Shtetërore Profesionale të zbatohet Rregullorja e Maturës Shtetërore 2015 në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Erion Veliaj

UDHËZIM
Nr. 5, datë 17.2.2015

PËR TË DREJTAT, DETYRAT, ZGJEDHJEN DHE MANDATIN E ANËTARËVE TË BORDEVE NË QENDRAT PUBLIKE TË FORMIMIT PROFESIONAL

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 7/1, pika 4, e ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Funksionet dhe detyrat e bordit

1. Funksionet e bordit:

a) Të mbështesë procesin e zhvillimit të qasjes strategjike të qendrës;

b) të japë pëlqimin ose jo në procesin e emërimit dhe largimit nga puna të personelit mësimor dhe të drejtuesve të qendrës;

c) të miratojë ose jo planet e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe financiare;

ç) të ofrojë këshilla dhe ndihmë për gjenerimin e të ardhurave shtesë, bazuar në aktivitetet dhe kapacitet e qendrës;

d) të nxisë bashkëpunimin me partnerë të tjerë, vendas e të huaj, që mund të kontribuojnë për veprimtarinë e qendrës.

2. Bordi shqyrton dhe miraton:

a) planin vjetor dhe afatmesëm të veprimtarisë së qendrës;

b) planin financiar për fondet që qendra merr nga buxheti i shtetit, fondet nga donatorë të huaj apo vendas, si dhe të ardhurat e realizuara nga vetë qendra;

c) Planin vjetor të veprimtarisë së bordit.

3. Bordi ka të drejtë të informohet për të gjitha aspektet e veprimtarisë së qendrës. Ai shqyrton mbi baza trimujore realizimin e planit dhe parashikimin për periudhat e ardhshme.

4. Në raste të veçanta, bordi mund të komunikojë drejtpërdrejt me organet e qeverisjes vendore në lidhje me aspekte problematike të zhvillimit të veprimtarisë së qendrës.

II. Përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të bordit

1. Procedurat për ngritjen e bordit kryhet nga drejtori i qendrës (më poshtë "drejtori").

2. Bordi i qendrës është organ kolegjial dhe përbëhet nga:

a) Dy përfaqësues të sektorit privat që lidhen me profilet që ka qendra;

b) një përfaqësues i njësisë arsimore vendore;

c) një përfaqësues i këshillit të qarkut, që mbulon qendrën;

ç) një përfaqësues i zyrës rajonale/vendore të punësimit, që mbulon qendrën;

d) një përfaqësues i personelit mësimdhënës të qendrës;

dh) një përfaqësues i punëmarrësve.

3. Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të bordit:

a) Përfaqësuesit e sektorit privat zgjidhen nga sektori privat sipas profileve përkatëse. Përparësi kanë sektorët të cilët përfaqësojnë profilin që ka numrin më të madh të kursantëve ose kanë pranuar numrin më të madh të praktikantëve ose kanë financuar qendrën më shumë gjatë 2 viteve të fundit;

b) përfaqësuesit e institucioneve, [germat "b" dhe "c" të pikës 2] caktohen nga institucionet përkatëse;

c) përfaqësuesi i personelit mësimdhënës zgjidhet me votim të fshehtë nga personeli mësimdhënës i qendrës.

4. Drejtori i kërkon zyrtarisht institucioneve përkatëse të caktojnë personat që do të marrin pjesë në bord.

5. Bordi i qendrës mbështetet nga sekretari i bordit.

III. Kryetari i bordit

1. Kryetar i bordit zgjidhet një nga përfaqësuesit e sektorit privat, profili i të cilit ka numrin më të madh të kursantëve në qendër.

2. Në mungesë të kryetarit, mbledhjet i drejton përfaqësuesi tjetër i sektorit privat.

3. Kryetari e ushtron detyrën për një mandat katërvjeçar me të drejtë ripërtëritje.

4. Kryetari i bordit ka këto detyra:

a) Drejton veprimtarinë e bordit;

b) ndan detyrat mes anëtarëve të bordit;

c) drejton hartimin e planit vjetor të bordit;

ç) sipas nevojave, fton në mbledhjet e bordit drejtuesit e qendrës, mësues, përfaqësues të kursantëve etj.

5. Për moskryerjen e detyrave ose për mungesa të vazhdueshme në mbledhjet e bordit, kryetari shkarkohet me shumicë të thjeshtë, me votim të fshehtë.

6. Votimi për shkarkimin e kryetarit zhvillohet kur kërkohet nga të paktën gjysma e anëtarëve të bordit.

IV. Anëtarët e bordit

1. Anëtarët e bordit e ushtrojnë detyrën për një mandat katërvjeçar, me të drejtë ripërtëritje.

2. Në rast se një anëtar i bordit mungon pa arsye, në më shumë se gjysmën e mbledhjeve të bordit gjatë një viti, kryetari i bordit i kërkon drejtorit të qendrës të nisë procedurën për zëvendësimin e tij.

3. Anëtarët e bordit nuk mund të autorizojnë një person të tretë, për të marrë pjesë në mbledhjet e bordit. Përjashtim nga ky rregull bëjnë anëtarët e përcaktuar në pikën II/2 germat "c" dhe "ç".

V. Sekretari i bordit

1. Sekretari i bordit është një punonjës i qendrës, i caktuar prej drejtorit.

2. Sekretari i bordit ka këto detyra:

a) Përgatit materialet për mbledhjet e bordit;

b) mban procesverbalin e mbledhjeve të bordit;

c) zbardh vendimet e bordit;

ç) lajmëron anëtarët e bordit për mbledhjen e ardhshme;

d) dorëzon në arkivin e qendrës procesverbalet e mbledhjeve, si dhe dokumentet e tjera.

VI. Mbledhjet e bordit

1. Bordi mblidhet 4 herë në vit.

2. Bordi mund të mblidhet jashtë radhe me kërkesë të drejtorit, të kryetarit, apo të gjysmës së anëtarëve.

3. Mbledhjet e bordit quhen të vlefshme kur marrin pjesë të paktën 4 anëtarë. Nëse numri i anëtarëve të pranishëm është më i vogël, mbledhja e bordit shtyhet për një datë tjetër sa më të afërt.

4. Bordi merr vendime me shumicë të thjeshtë votash. Në rast se votimi i një çështjeje merr numër të njëjtë votash pro e kundër, do të merret vendimi i grupit në të cilin merr pjesë kryetari i bordit. Vendimet nënshkruhen nga kryetari dhe sekretari.

5. Vendimet që merr bordi pasqyrohen në librin e procesverbaleve.

6. Procesverbali zbardhet dhe u dërgohet të gjithë anëtarëve të bordit, brenda një jave nga data e zhvillimit të mbledhjes.

7. Anëtarët e bordit përfitojnë shpërblim vetëm për 4 mbledhje në vit nga të ardhurat e qendrës, nëse ajo realizon të ardhura.

8. Në mbledhjen e tij të parë, bordi ose anëtarët e rinj, njihen me aktet dhe dokumente të tjera që kanë të bëjnë me realizimin e qëllimit, funksionet dhe detyrat të bordit.

VII. Roli i drejtorit të qendrës

1. Drejtori nuk është anëtar i bordit.

2. Drejtori ka për detyrë të njohë bordin me aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me veprimtarinë e qendrës.

3. Drejtori, ka për detyrë të përpilojë dhe të paraqesë dokumentet për të cilat bordi duhet të japë pëlqimin ose miratimin.

4. Drejtori ka detyrë të raportojë për çështje të mbarëvajtjes së qendrës, sa herë kjo i kërkohet nga bordi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj

UDHËZIM
Nr. 9, datë 27.2.2015

MBI MARRËVESHJET E ÇMIMIT NË AVANCË

Në përputhje me nenin 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në mbështetje të paragrafit 3 të nenit 36/7, të ligjit nr. 8438, datë 28.12,1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndyshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Dispozita të përgjithshme

1.1 Ky udhëzim përcakton rregullat dhe procedurat për administrimin dhe zbatimin e nenit 36/7, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, mbi marrëveshjet e çmimit në avancë.

2. Marrëveshjet e çmimit në avancë (MÇA) dhe llojet e tyre

2.1 "Marrëveshje çmimi në avancë" (MÇA) është një marrëveshje procedurale ndërmjet një apo më shumë tatimpaguesve dhe një apo më shumë administratave tatimore, me qëllim zgjidhjen në avancë të mosmarrëveshjeve të mundshme të transferimit të çmimit, duke përcaktuar para kryerjes së transaksioneve të kontrolluara, një grup kriteresh të përshtatshme për përcaktimin e përputhshmërisë së këtyre transaksioneve me parimin e tregut.

2.2 Llojet e marrëveshjeve që mbulohen nga ky udhëzim përfshijnë:

a) Marrëveshjet e njëanshme të çmimit në avancë, përmes të cilave lidhet një marrëveshje ndërmjet një tatimpaguesi dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) në lidhje me zbatimin e nenit 2 (4), neneve: 36-36/7 të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, për transaksionet e kontrolluara të specifikuara;

b) marrëveshjet dypalëshe të çmimit në avancë, përmes të cilave një tatimpagues kërkon që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të arrijë marrëveshje me një partner të konventës së shmangies së tatimit të dyfishtë (autoriteti tatimor i shtetit tjetër kontraktues) në lidhje me zbatimin e nenit të ndërmarrjeve të lidhura të konventës përkatëse të shmangies së taksimit të dyfishtë në transaksionet e kontrolluara të specifikuara;

c) marrëveshjet shumëpalëshe të çmimit në avancë, përmes të cilave një tatimpagues kërkon që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve arrin marrëveshje me dy apo më shumë partnerë të konventës së shmangies së tatimit të dyfishtë në lidhje me aplikimin e neneve të ndërmarrjeve të lidhura për transaksionet e kontrolluara të specifikuara.

2.3 Kur një marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe e çmimit në avancë e nënshkruar ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe një apo më shumë partnerëve të konventave tatimore të taksimit të dyfishtë hyn në fuqi, kjo marrëveshje reciproke (në bazë të nenit mbi procedurën e marrëveshjes reciproke të konventës përkatëse tatimore) do të jetë bazë për Marrëveshjen e Çmimit në Avancë në Shqipëri dhe në përputhje me këtë marrëveshje.

2.4 Paragrafi 2.2 pikat "b" dhe "c" janë të zbatueshme vetëm në rastet kur një apo më shumë konventa tatimore, apo konventa të ngjashme, janë të zbatueshme dhe konventat në fjalë përmbajnë dispozitat në lidhje me ndërmarrjet e lidhura.

3. Garancia e dhënë nga Marrëveshjet e Çmimit në Avancë

3.1 Në zbatim të nenit 36/7 pika 2, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, kur një tatimpagues ka hyrë në një Marrëveshje të Çmimit në Avancë, asnjë rregullim nuk do të bëhet në përputhje me nenin 36, pika 3 e ligjit "Për tatimin mbi të

ardhurat", te transaksionet e kontrolluara të specifikuara, me kushtin që të jenë plotësuar afatet dhe kushtet e Marrëveshjes së Çmimit në Avancë.

3.2 Përveçse në rrethana të veçanta, Marrëveshjet e Çmimit në Avancë nuk kanë për qëllim të përcaktojnë fitimet e tatueshme apo të ardhurat për t'u tatuar në Shqipëri. Marrëveshjet e Çmimit në Avancë do të specifikojnë dhe përcaktojnë një sërë kriteresh të përshtatshme (p.sh. metodën e transferimit të çmimit, krahasueshmëritë apo faktorët e krahasueshmërisë dhe rregullimet e përshtatshme mbi to, supozimet kritike për sa i përket ngjarjeve të ardhshme) në përputhje me parimin e palëve të pavarura për ato transaksione të kontrolluara gjatë një periudhe të caktuar kohe.

4. Pritshmëritë dypalëshe të tatimpaguesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

4.1 Pritshmëritë e përbashkëta të tatimpaguesit dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, kur ato janë të nevojshme, parashikohen në shtojcën 1 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi. Mungesa e plotësimit të pritshmërive të përbashkëta qoftë nga DPT apo tatimpaguesi mund të rezultojnë në përfundimin apo revokimin e procesit të MÇA-së, qoftë nga ana e DPT apo edhe nga ana e tatimpaguesit.

5. Pranueshmëria

5.1 Kërkesat e çmimit në avancë do të merren në konsideratë nëse transaksionet e kontrolluara për të gjithë periudhën që do të mbulojë marrëveshja, tejkalojnë në shumë totale vlerën prej 30 milionë euro. Pra, nëse do të kemi një për një marrëveshje për periudhë 3-vjeçare, shuma e transaksioneve me palët e lidhura duhet të kalojë 30 milionë euro për të tri vitet të marra së bashku. Nëse do të kemi një marrëveshje për një periudhë 5-vjeçare, shuma e transaksioneve me palët e lidhura duhet të kalojë 30 milionë euro për të pesë vitet e marra së bashku.

5.2 Kur transaksionet e kontrolluara të parashikuara për t'u mbuluar nga marrëveshja nuk e tejkalojnë shumën e parashikuar në pikën 5.1, kërkesat mund të pranohen nga DPT, me kushtin që rasti është mjaftueshmërisht kompleks ose është i një rëndësie të lartë tregtare apo ekonomike për Shqipërinë.

6. Pagesa e komisionit të aplikimit

6.1 Aplikimi për një marrëveshje të çmimit në avancë i paraqitur sipas paragrafit 11 të këtij udhëzimi, shoqërohet me një pagesë të pakthyeshme prej 50.000 lekë.

6.2 Me përfundimin e fazës së parë të procedurës së MÇA-së, në përputhje me pikën 9.1, në momentin e fillimit të fazës 2, aplikimit zyrtar, tatimpaguesi duhet të ketë paguar tarifën administrative si më poshtë:

a) Në rastin e një marrëveshjeje të njëanshme të çmimit në avancë, 300.000 lekë;

b) në rastin e një marrëveshjeje dypalëshe të çmimit në avancë 1.200.000 lekë; dhe

c) në rastin e një marrëveshjeje shumëpalëshe të çmimit në avancë 1.200.000 lekë.

6.3 Në rastet kur DPT, pas analizimit paraprak të dokumentacionit, me përfundimin e fazës 2 dhe 3 sipas pikës 9.1 të këtij udhëzimi, refuzon aplikimin në rrugë zyrtare, atëherë DPT i rimburson tatimpaguesit 90% të tarifës së paguar sipas pikës 6.2 më lart, brenda 30 ditëve nga data e refuzimit.

6.4 Pagesa e tarifës nuk i heq të drejtën tatimpaguesit të tërhiqet nga procesi i marrëveshjes së çmimit në avancë, ose të drejtën DPT-së për t'u tërhequr nga bisedimet në zbatim të paragrafit 16 të këtij udhëzimi.

6.5 Me pranimin e kërkesës së tatimpaguesit për marrëveshjen e çmimit në avancë dhe fillimin e negociatave sipas pikës 9.1, faza 4 "Negocimi", pagesa e tarifës së aplikimit nuk i kthehet tatimpaguesit për asnjë rrethanë.

6.6 Tarifat e përcaktuara në këtë dispozitë paguhen nga tatimpaguesit në emër të DPT-së, në llogarinë e të ardhurave të thesarit, të Degës së Thesarit Tiranë, në klasën 46655 "Depozitime të përkohshme për marrëdhëniet me administratën tatimore", në llogarinë ekonomike 4665501 "Depozitime të përkohshme nga tarifat e aplikimit të Marrëveshjeve të Çmimit në Avancë". Për këtë tatimpaguesi do të plotësojë faturën për arkëtim me formatin ekzistues të cilin e paraqesin në bankë në momentin e pagesës. Dega e thesarit bën kontabilizimin e

transaksionit duke e evidentuar atë për çdo tatimpagues (në nënllogarinë teknike të çelur specifikisht në SIFQ për çdo tatimpagues).

DPT-ja rakordon rregullisht, në mbyllje të periudhës kontabël ose përpara saj nëse është e domosdoshme, me Degën e Thesarit Tiranë dhe shumat nga tarifat që nuk i kthehen tatimpaguesve, do ta transferojnë në llogarinë përkatëse të të ardhurave nëpërmjet metodës së xhirimeve të brendshme brenda institucionit. Këto shuma përdoren nga DPT vetëm në funksion të administrimit të procesit të negocimit dhe zbatimit të Marrëveshjeve të Çmimit në Avancë.

7. Periudha maksimale e mbulimit

7.1 Data e fillimit e MÇA-së duhet të jetë viti fiskal që vijon datën e nënshkrimit të marrëveshjes.

7.2 Periudha maksimale e mbulimit për marrëveshjet e çmimit në avancë është 5 (pesë) vite, me përjashtim të rasteve kur Marrëveshja e Çmimit në Avancë i përket zbatimit të një marrëveshjeje reciproke qeveritare të ratifikuar me ligj.

7.3 Tatimpaguesit nuk mund të kërkojnë një MÇA për një periudhë të mbuluar të disa viteve të mëparshme (referuar si "rikthimi viteve"). Megjithatë, në kuptimin që MÇA është nënshkruar dhe përfunduar pas vitit të parë fiskal të MÇA-së së propozuar, viti tatimor gjatë të cilit është propozuar MÇA-ja do të mbulohet nga marrëveshja.

8. Fusha e kërkesës dhe trajtimi i çështjeve anësore

8.1 Fusha e kërkesës kufizohet te marrëveshjet në lidhje me zbatimin e parimit të palëve të pavarura në transaksionet e kontrolluara sikurse përcaktohet në germën "d", të pikës 4, të nenit 2, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.

8.2 Kur transaksionet e kontrolluara që do të mbulohen nga MÇA-ja mbulohen nga një konventë tatimore në zbatim, aplikimet duhet të bëhen për MÇA dypalëshe ose shumëpalëshe. Aplikimet për MÇA të njëanshme në raste të tilla do të pranohen vetëm në raste të veçanta (p.sh. kur partneri i konventës tatimore nuk dëshiron të hyjë në negociata).

8.3 Në rastet kur çështjet indirekte (të tilla si: zbritshmëria e shpenzimeve, zbatueshmëria e tatimit në burim, ekzistenca e selisë së përhershme, atribuimi i fitimit te njësia e përhershme e kështu me rradhë) identifikohen në fazën e paradorëzimit, fazën e aplikimit apo të vlerësimit, këto çështje mund t'i paraqiten DPT-së për t'u marrë në konsideratë për hartimin e një rregullorejeje në avancë në pajtueshmëri me nenin 36/7, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998. Problemet indirekte nuk do të trajtohen në vetë Marrëveshjen e Çmimit në Avancë dhe marrëveshja do të negociohet apo do të hyjë në fuqi pavarësisht çështjeve të tilla.

8.4 DPT ka të drejtën të shtojë në kërkesën e Marrëveshjes së Çmimit në Avancë të tatimpaguesit, transaksione të tjera që do të mbulohen nga marrëveshja, në rastet kur transaksionet janë të ndërlidhura në mënyrë të tillë që duhen analizuar së bashku.

9. Procedura e MÇA-së (Marrëveshjes së Çmimit në Avancë)

9.1 Procedura e Marrëveshjes së Çmimit në Avancë në Shqipëri përfshin 6 faza:

Faza 1– Takimi i paradorëzimit të kërkesës;

Faza 2- Aplikimi zyrtar;

Faza 3- Vlerësimi;

Faza 4- Negocimi;

Faza 5- Hartimi dhe ekzekutimi;

Faza 6- Raporti vjetor i pajtueshmërisë.

9.2 Secila prej 6 fazave trajtohet në detaje në paragrafët 10-15 të këtij udhëzimi.

10. Takimi paradorëzimit (faza 1)

10.1 Procedura e MÇA-së fillon me zhvillimin e takimeve para dorëzimit. Qëllimi i këtyre takimeve është t'i lejojë të gjitha palëve të vlerësojnë suksesin e marrëveshjes së propozuar të çmimit në avancë. Ajo lejon DPT që të bëjë një gjykim paraprak nëse aplikimi do jetë i pranueshëm, si dhe të qartësojë pritshmëritë e të dyja palëve.

10.2 Për të mundësuar vlerësimin e suksesit të marrëveshjes shqiptare të çmimit në avancë të propozuar, bëhen takime para dorëzimit të dosjes në përputhje me formularin e pyetësorit të paradorëzimit të specifikuar në shtojcën 2.

10.3 Mbledhjet e paradorëzimit mbahen në baza anonime nëse sigurohet informacion i mjaftueshëm nga tatimpaguesi ose përfaqësuesi i

tyre, si pjesë e pyetësorit të paradorëzimit të shtojcës 2.

10.4 Me marrjen e pyetësorit të paradorëzimit, DPT-ja do të kontaktojë tatimpaguesin ose përfaqësuesin e tij për të diskutuar për kohën dhe vendin e takimit. Takimet duhet të mbahen brenda 60 ditëve nga paraqitja e kërkesës për takimin e paradorëzimit, përveçse kur palët bien dakord ndryshe.

10.5 Materialet shtesë apo dosja për prezantimin në takimin e paradorëzimit, do t'i dërgohen DPT-së të paktën një javë para takimit. Në rast të kundërt takimi mund të riplanifikohet.

10.6 Çdo deklaratë ose paraqitje e bërë gjatë takimit të paradorëzimit nga DPT-ja përbën këshillë jo zyrtare lidhur me aplikimin e propozuar dhe nuk është detyruese për DPT-në.

10.7 Nëse gjatë takimeve të paradorëzimit përcaktohet që aplikimi për MÇA i tatimpaguesit, që do t'i nënshtrohet paragrafit 11 të këtij udhëzimi, është i pranueshëm për DPT-në, tatimpaguesi duhet të informohet me shkrim brenda 60 ditëve nga takimi i paradorëzimit.

10.8 Nëse, gjatë takimeve të paradorëzimit përcaktohet se aplikimi për MÇA-në i tatimpaguesit nuk pranohet nga DPT, tatimpaguesi informohet me shkrim brenda 30 ditëve nga mbledhja e paradorëzimit duke dhënë edhe arsyet e mospranimit të aplikimit, siç ishte përcaktuar në takimin e paradorëzimit. Arsyet e mundshme të papranueshmërisë së aplikimit për MÇA-në, janë si më poshtë vijon:

- transaksionet e propozuara për t'u mbuluar nga Marrëveshja e Çmimit në Avancë nuk konsiderohen si të përshtatshme për një Marrëveshje të Çmimit në Avancë;
- tatimpaguesi paraqet risk për mospërmbushje të detyrimeve; ose
- ka çështje të tjera komplekse që kërkojnë rizgjidhje paraprake përpara konsiderimit të marrëveshjes së çmimit në avancë (p.sh. ekzistencën e një selie të përhershme dhe konsiderata të tjera materiale).

10.9 Nëse gjatë takimeve të paradorëzimit përcaktohet se kërkohet informacion shtesë përpara se aplikimi për MÇA nga tatimpaguesi të mund të pranohet nga DPT-ja, tatimpaguesi do të informohet me shkrim mbi informacionin shtesë të kërkuar dhe tatimpaguesit do t'i jepen mundësitë e arsyeshme për ta prezantuar informacionin e kërkuar brenda 30 ditëve, para se të bëhet njoftimi sipas paragrafit 10.7 apo paragrafit 10.8.

11. Aplikimi zyrtar (faza 2)

11.1 Nëse tatimpaguesi ka si qëllim të procedojë me një aplikim zyrtar për një Marrëveshje Çmimi në Avancë, siç parashikohet në takimin e paradorëzimit, aplikimi për një Marrëveshje Çmimi në Avancë bëhet në përputhje me informacionin e paraqitur në shtojcën 3, duke marrë në konsideratë kriteret e pranueshme në paragrafin 5 të këtij udhëzimi.

11.2 Nëse kërkesa bëhet për një MÇA dypalëshe ose shumëpalëshe, tatimpaguesi duhet të dorëzojë aplikimin në të njëjtën kohë tek autoritetet kompetente të të gjitha juridiksioneve të huaja tatimore, në të gjitha rastet.

11.3 DPT-ja do të pranojë marrjen e aplikimit zyrtar të MÇA-së me shkrim nëpërmjet një shkrese informuese brenda 60 ditëve të konfirmimit të marrjes së aplikimit në zyrën e DPT-së. Shkresa informuese duhet të njoftojë nëse aplikimi është pranuar ose jo.

11.4 Nëse aplikimi pranohet, letra informuese do të përmbajë informacionet si më poshtë vijon:

1. Nëse aplikimi i MÇA-së reflekton mirëkuptimin e DPT në takimin e paradorëzimit;
2. Nëse aplikimi MÇA-së është në thelb i plotësuar bazuar në informacionin e kërkuar të përcaktuar në shtojcën 3.
3. Tarifa përkatëse e aplikimit të MÇA-së është paguar dhe pranuar, dhe
4. Të dhënat e personit/personave të kontaktit të DPT të caktuar për vlerësimin e aplikimit.

11.5 Nëse aplikimi refuzohet, shkresa informuese do të përmbajë arsyet e refuzimit.

11.6 Në rastet kur aplikimi nuk i përmbush kërkesat e shtojcës 3, shkresa informuese jep ndryshimet e kërkuara për procedimin e aplikimit në vlerësimin e MÇA-së.

11.7 Një pranim i aplikimit për një MÇA nuk sugjeron apo përcakton me siguri që DPT-ja dhe tatimpaguesi do të përfundojnë Marrëveshjen e Çmimit në Avancë, apo të sigurojë se do të përdoren metodat e propozuara. Megjithatë, një aplikim i pranuar i MÇA-së nënkupton që DPT-ja do të ndërmarrë procedurat, sikurse trajtohen në paragrafët 11 dhe 12 të këtij udhëzimi, në varësi të

plotësisë së informacionit të paraqitur, siç përcaktohet në shtojcën 3.

11.8 Për aplikimet dypalëshe të MÇA-së, sapo të jetë administrativisht i mundur, por jo më vonë se 60 ditë pas marrjes dhe pranimit të aplikimit zyrtar të MÇA-së, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të kontaktojë me partnerin/partnerët e konventës tatimore dhe pyet nëse ai/ata dëshirojnë të procedojnë me aplikimin brenda kontekstit të konventës tatimore.

11.9 Nëse tatimpaguesi nuk ka pasur më parë një takim paradorëzimit me DPT-në sipas paragrafit 10 të këtij udhëzimi, DPT-ja me zgjedhjen e saj, mund të kërkojë takimin me tatimpaguesin.

12. Vlerësimi (faza 3)

12.1 Pasi aplikimi i MÇA-së është pranuar dhe është në thelb i plotë, DPT brenda 60 ditëve punë kryen një analizë kritike të aplikimit të MÇA-së përpara se të ndërmarrë punën fillestare për të vendosur përfundimin e çmimit të pavarur. Megjithatë, DPT mund të ndërmarrë punën fillestare duke përfshirë punën në terren, kur kushtet e garantojnë.

12.2 Si pjesë e analizës gjatë vlerësimit të marrëveshjes së çmimit në avancë, DPT-ja mund të ndërmarrë veprimtaritë e mëposhtme:

- T'i kërkojë tatimpaguesit për të dhënë informacion shtesë, duke përfshirë informacionin lidhur me palët e lidhura;
- kërkon takime me tatimpaguesin me qëllim që të diskutojnë çështje specifike;
- ndërmerr kërkime të fushës dhe vizita në terren për të inspektuar veprimtaritë e tatimpaguesit;
- interviston personelin e tatimpaguesit;
- kërkon informacione të vlefshme nga partnerët e konventës tatimore nën shkëmbimin e informacionit në pajtim me dispozitat përkatëse të një konvente të aplikueshme tatimore, dhe/ose
- ushtron çdo kompetencë përkatëse sipas legjislacionit fiskal për vlerësimin e marrëveshjes.

12.3 Kur DPT-ja bën një vlerësim të ndryshëm nga ai që përmban aplikimi i tatimpaguesit, ajo do ta diskutojë vlerësimin e saj me tatimpaguesin. DPT-ja do të kërkojë që tatimpaguesi të shprehet mbi pozicionin e tij në lidhje me këtë vlerësim me qëllimin për të arritur një marrëveshje të përbashkët me tatimpaguesin.

12.4 Gjatë vlerësimit të Marrëveshjes së Çmimit në Avancë, tatimpaguesit i kërkohet që:

- të mundësojë personelin dhe mjediset e nevojshme respektivisht për intervistë dhe inspektim; dhe
- të marrë dhe japë informacione lidhur me palët e lidhura.

12.5 Nëse aplikimi është dypalësh ose shumëpalësh nën kushtet e Konventës Tatimore Shqiptare, do të aplikohet procedura e mëposhtme:

- Tatimpaguesi duhet të këshillojë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për informacionin/ dokumentacionin e kërkuar nga partnerët e konventës tatimore në lidhje me aplikimin dhe duhet të sigurohet që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është pajisur me kopjet e çdo informacioni/dokumentacioni të paraqitur te partneri/ët e konventës tatimore, qoftë nga ai vetë apo një palë e lidhur;

13. Negocimi (faza 4)

MÇA e njëanshme

13.1 Sapo DPT-ja përfundon analizat e saj, ajo njofton me shkrim brenda 10 ditëve tatimpaguesin me anë të një letre, e cila paraqet pozicionin e DPT-së, dhe jep shpjegimin në masën që pozicioni i saj është i ndryshëm nga propozimi i tatimpaguesit në aplikim.

13.2 Nëse ka ndryshime ndërmjet pozicionit të tatimpaguesit dhe pozicionit të DPT-së lidhur me MÇA-në, tatimpaguesi duhet t'i paraqesë me shkrim DPT-së arsyetimin e tij lidhur me metodën e transferimit të çmimit apo kushteve të tjera të MÇA-së së propozuar, para fillimit të takimeve individuale.

13.3 Pas marrjes së përgjigjes nga tatimpaguesi, sikurse jepet në pikën 13.2, nëse ka ende ndryshime ndërmjet pozicioneve, DPT-ja do t'i mundësojë tatimpaguesit një takim brenda 15 ditëve për të diskutuar çështjet, me synimin për të arritur një marrëveshje.

MÇA dypalëshe ose shumëpalëshe

13.4 Në rastin e një MÇA-je dypalëshe ose shumëpalëshe, DPT do të shkëmbejë letra për qëndrimin e saj me autoritetin/et kompent/te të huaj/a palë e MÇA-së, dhe do të ndjekë procedurat e mëposhtme:

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund të bëjë takime individuale me palën e autoritetit kompetent të huaj në MÇA;

- tatimpaguesi nuk e ka të drejtën të shohë qëndrimin e shprehur ose materialet e tjera të shkëmbyera me shkrim ndërmjet autoriteteve kompetente si palë në procesin e negocimit. Dokumente të tilla jepen sipas procedurës së marrëveshjes reciproke të konventës përkatëse tatimore, e cila kufizon përdorimin dhe zbulimin e saj;

- tatimpaguesi nuk ka të drejtën të jetë i pranishëm në negocimin e autoritetit kompetent, përveç rasteve kur aprovimi për paraqitje në mbledhjet e Autoriteteve Kompetente është marrë nga të gjitha autoritetet kompetente të interesuara; dhe

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të mbajë tatimpaguesin të përditësuar mbi statusin e negociatave dypalëshe dhe t'i komunikojë çdo afat kohor të rënë dakord me autoritetin tjetër kompetent, sipas nevojës.

13.5 Në rastin e marrëveshjeve bilaterale, autoritetet kompentente të shteteve kontraktore mund të bien dakord me një marrëveshje të përbashkët me shkrim e cila përcakton metodën e pranuar të transferimit të çmimit, aplikimin e saj dhe supozimet kritike. Marrëveshja e përbashkët mund të jetë në çdo formë shkresore e shkëmbyer midis autoriteteve kompetente të dy palëve.

13.6 Tatimpaguesi mund të pranojë ose të refuzojë marrëveshjen e përbashkët për MÇA-në. Tatimpaguesi duhet të njoftojë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me shkrim, nëse marrëveshja e përbashkët është pranuar apo jo, brenda 30 ditëve kalendarike.

13.7 Kur marrëveshja e përbashkët është pranuar, DPT-ja harton një MÇA bazuar në marrëveshjen e përbashkët dhe ja paraqet këtë tatimpaguesit për nënshkrim. Tatimpaguesit i kërkohet t'a nënshkruajë MÇA-në përfundimtare dhe t'ia kthejë atë DPT-së.

13.8 Në rastet kur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk është në gjendje të arrijë marrëveshjen me partnerin (ose partnerët) e konventës tatimore brenda 90 ditëve, atëherë në këto rrethana, një MÇA e njëanshme mund të lidhet me tatimpaguesin. Në këto raste Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton me shkrim tatimpaguesin.

13.9 Në rastin e të gjitha MÇA-ve, përmbajtja e marrëveshjes së arritur (transaksionet e mbuluara, personat juridik të mbuluar, periudha, metoda e aplikuar e transferimit të çmimit, rezultatet dhe konsideratat përkatëse) të rëna dakord në MÇA, mund të ndryshojnë nga ato të propozuara në aplikimin e tatimpaguesit.

14. Hartimi dhe marrëveshja (faza 5)

14.1 Në përputhje me sa është rënë dakord në negociata, DPT-ja do të përgatisë versionin përfundimtar të MÇA-së dhe do t'ia dërgojë atë brenda tatimpaguesit për ta nënshkruar e zbatuar. Një kopje e nënshkruar i kthehet DPT-së brenda 10 ditëve.

14.2 Forma dhe përmbajtja e MÇA-së së përfunduar.

Një MÇA e përfunduar duhet të përmbajë së paku informacionin e mëposhtëm:

- Emrin dhe adresat e palëve në MÇA;

- transaksionet e kontrolluara të mbuluara nga MÇA;

- periudhën dhe vitet tatimore të mbuluara nga MÇA;

- metodologjinë e transferimit të çmimit të rënë dakord dhe zbatimin e saj ndaj transaksioneve të kontrolluara të mbuluara;

- nëse është e aplikueshme, vargun e çmimeve të palëve të pavarura të pranuar në MÇA;

- një përcaktim të kushteve përkatëse të cilat formojnë bazën e llogaritjes së metodologjisë së transferimit të çmimit;

- standardet e llogaritjeve të bëra mbi të cilat bazohet deklarimi financiar;

- gjykimet kritike mbi të cilat është bazuar metodologjia e transferimit të çmimit;

- procedurat që duhen ndjekur nëse është e nevojshme për të bërë rregullime kompensuese; dhe

- detyrimet që rrjedhin për tatimpaguesin si rezultat i MÇA-së (p.sh. detyrimi i tatimpaguesit për të dorëzuar raportet vjetore të pajtueshmërisë dhe regjistrimet e tatimpaguesit që plotësojnë kërkesat).

Supozimet kritike

14.3 Një MÇA do të përcaktojë në avancë supozimet kritike, duke përfshirë edhe ato supozime të cilat nuk janë në kontrollin e

tatimpaguesit ose të DPT-së. Këto supozime përfshijnë çdo fakt mbi tatimpaguesin, një filial, një palë të tretë, një industri apo kushte ekonomike të përgjithshme. Supozimi është kritik nëse shkelja e tij mund të ndikojë ndjeshëm në zbatimin e kushteve thelbësore të MÇA-së ose në bazat mbi të cilat ajo është rënë dakord. Supozimet kritike nga natyra e tyre janë thelbësore për MÇA-në dhe duhen hartuar me kujdes për të siguruar që MÇA-ja reflekton parimin e tregut dhe mbron sigurinë e MÇA-së.

14.4 DPT-ja do të vlerësojë nëse palët e pavarura kanë parashikuar ngjarje ose rrethana në kohën kur MÇA-ja ka hyrë në fuqi dhe nëse metodologjia e transferimit të çmimit të pranuar është marrë ose jo sa duhet në konsideratë. DPT-ja do të përdorë testin e palëve të pavarura për të përcaktuar nëse ato do të kishin rinegociuar një marrëveshje të tillë në sajë të ndryshimit në supozimet kritike.

14.5 Tatimpaguesi duhet të njoftojë me shkresë zyrtare DPT-në se një supozim kritik është shkelur dhe të dorëzojë dokumentacionin mbështetës me një kurs veprimi të propozuar (p.sh. rishikimin e MÇA-së) brenda 30 ditëve.

14.6 DPT-ja do të vlerësojë nëse palët e pavarura pritet arsyeshëm se kanë parashikuar ngjarje ose rrethana në kohën kur MÇA-ja ka hyrë në fuqi dhe nëse metodologjia e transferimit të çmimit të pranuar është marrë sa duhet në konsideratë. DPT-ja do të përdorë testin e palëve të pavarura për të përcaktuar nëse palët e pavarura do të kishin rinegociuar një marrëveshje të tillë në sajë të ndryshimit në supozimet kritike.

Nëse MÇA-ja rishikohet, data efektive e rishikimit të MÇA-së do të shprehet në MÇA-në e rishikuar. MÇA-ja e rishikuar duhet të shënojë gjithashtu datën mbi të cilën MÇA-ja origjinale nuk është më efektive.

Nëse një MÇA e rishikuar nuk mund të negociohet, ajo do të anulohet ose pezullohet. MÇA-ja do të anulohet ose pezullohet nga fillimi i vitit në të cilën ndodhi ngjarja që solli ndryshimin e rrethanave. Në përgjithësi, një MÇA ka si qëllim të jetë e zbatueshme për të gjithë vitin ose të jetë e pazbatueshme për të gjithë atë vit.

15. Raporti vjetor i pajtueshmërisë (faza 6)

15.1 DPT mund të auditojë një tatimpagues që është palë në një marrëveshje çmimi në avancë si pjesë e auditit të rregullt të tij tatimor, megjithatë, në lidhje me transaksionin e mbuluar në MÇA, qëllimi i auditimit do të kufizohet në plotësimin e dispozitave të marrëveshjes së çmimit në avancë.

15.2 Për çdo periudhë tatimore të mbuluar nga marrëveshja e çmimit në avancë, tatimpaguesi është i detyruar t'i dorëzojë në DPT raportin vjetor të pajtueshmërisë së MÇA-së së përfunduar. Forma dhe përmbajtja e raportit vjetor të pajtueshmërisë së MÇA-së specifikohet në shtojcën 4 të këtij udhëzimi.

15.3 Data e duhur për dorëzimin e raportit vjetor të pajtueshmërisë së MÇA-së është data e detyrueshme për dorëzimin e "Deklaratës së tatimit mbi fitimin" dhe "Formularit të pagesës". Ajo mund të dorëzohet e printuar me bilancin dhe pasqyrat financiare ose në mënyrë elektronike, siç kërkohet nga DPT-ja.

15.4 Nëse tatimpaguesi nuk dorëzon raportin e pajtueshmërisë vjetore, ose dorëzon një njoftim të pasaktë ose të paplotësuar të raportit vjetor të pajtueshmërisë, kjo do të konsiderohet si papajtueshmëri me një nga dispozitat e marrëveshjes së çmimit në avancë për qëllimin e paragrafit 17 të këtij udhëzimi.

16. E drejta e tërheqjes dhe refuzimit

16.1 Në rastin e marrëveshjeve të njëanshme të çmimit në avancë, tatimpaguesi ose DPT mundet që në çdo kohë gjatë procesit, të tërhiqen nga procesi nëse ata vërejnë qartë se do të jetë e pamundur të përfundojnë me sukses një marrëveshje të çmimit në avancë. Tërheqja duhet të njoftohet me shkrim dhe arsyet e tërheqjes duhet të specifikohen qartë. Gjykohet që tërheqja të jetë rezultat i sjelljes në kundërshtim me shtojcën 1.

16.2 Në rastin e tërheqjes nga ana e DPT-së, tatimpaguesi ka të drejtë të ankimojë me shkrim pranë Drejtorit të Përgjithshëm tërheqjen brenda 30 ditëve. DPT, pas marrjes me shkrim të ankimimit mund ta rikonsiderojë tërheqjen e mëparshme dhe të riangazhohet në negocime.

16.3 Në rastin e Marrëveshjeve të Çmimit në Avancë, dypalëshe apo shumëpalëshe, tatimpaguesi mund të komunikojë me shkrim në çdo kohë synimin e tij për të refuzuar pranimin e rezultatit të negociatave, dhe mos të hyjë në një MÇA. Megjithatë, kjo bëhet pavarësisht nëse Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve tërhiqet apo jo nga negocimet me partnerin(ët) e konventës tatimore.

16.4 Në rastin kur është arritur një marrëveshje reciproke ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe partnerin/ët e tij të konventës tatimore, tatimpaguesi mund të hedhë poshtë marrëveshjen me anën e refuzimit për të mos hyrë në Marrëveshjen e Çmimit në Avancë. Në raste të tilla, tatimpaguesi humbet të drejtën e aplikimit për procedurën e marrëveshjes reciproke në lidhje me transaksionet e kontrolluara të mbuluara nga kjo marrëveshje. Përveç kësaj, tatimpaguesi humbet gjithashtu të drejtën për çdo MÇA të njëanshme lidhur me transaksionet e kontrolluara në fjalë.

17. Mosplotësimi i kërkesave të marrëveshjes

17.1 Nëse janë shkelur një ose më shumë dispozita të Marrëveshjes së Çmimit në Avancë , DPT-ja mundet, që në përputhje me paragrafët 18-20 të këtij udhëzimi, të ndryshojë, anulojë ose revokojë Marrëveshjen e Çmimit në Avancë.

17.2 Paragrafët 18-20 të këtij udhëzimi janë të zbatueshme në të gjitha rastet dhe nuk mund të parandalohen nga dispozitat e një Marrëveshjeje specifike të Çmimit në Avancë.

18. Rishikimi

18.1 DPT-ja, në konsultim me tatimpaguesin mundet të rishikojë dispozitat e Marrëveshjes së njëanshme të Çmimit në Avancë, nëse plotësohet njëra nga kushtet e mëposhtme:

- Ka një ndryshim material në zbatimin e legjislacionit tatimor shqiptar;
- të dyja palët, DPT-ja dhe tatimpaguesi kanë shprehur me shkrim dëshirën për të rishikuar dispozitat që vijnë si pasojë e ndryshimeve në ekonomi ose konsiderata të tjera përkatëse.

18.2 Data efektive e çdo rishikimi duhet të miratohet ndërmjet DPT-së dhe tatimpaguesit.

18.3 Në rastin e një rishikimi të marrëveshjes reciproke, Marrëveshja e Çmimit në Avancë që zbaton atë marrëveshje reciproke, për aq sa kërkohet, do të rishikohet në përputhje me rrethanat.

19. Anulimi

19.1 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund të anulojë një marrëveshje çmimi në avancë të njëanshme kur plotësohet njëra nga kushtet e mëposhtme:

- Ka pasur një keqprezantim, gabim ose mosveprim që nuk është pasojë e neglizhencës, pakujdesisë, ose mosveprim i qëllimshëm i tatimpaguesit kur ka plotësuar aplikimin, gjatë negocimeve të marrëveshjes, ose në përputhje me raportimin dhe përmbushjen e kërkesave;
- tatimpaguesi nuk përmbush një ose më shumë nga dispozitat e Marrëveshjes së Çmimit në Avancë;
- ka shkelje materiale të një apo më shumë nga supozimet kritike; dhe/ose
- kur paragrafi 18 është i aplikueshëm, por asnjë marrëveshje nuk është e mundur të arrihet, ndërmjet DPT-së dhe tatimpaguesit, brenda një periudhë prej 60 ditësh.

19.2 Marrëveshja e Çmimit në Avancë do të pushojë së qeni e zbatueshme nga data e anulimit.

19.3 Data e anulimit do të përcaktohet sipas datës së ngjarjes që solli anulimin. Nëse një datë e tillë nuk mund të përcaktohet, p.sh. kur ndodh një ndryshim material në një nga supozimet kritike, anulimi do të jetë efektiv nga viti tatimor në të cilin ka ndodhur ngjarja. Efekti i anulimit është i tillë që DPT-ja dhe tatimpaguesi nuk do të jenë më të detyruar nga marrëveshja që nga data e anulimit.

19.4 DPT-ja mund të heqë dorë nga anulimi nëse tatimpaguesi mund të tregojë se ka shkaqe të arsyeshme, dhe palët bien dakord në një rishikim të marrëveshjes në përputhje me paragrafin 18 të udhëzimit.

19.5 Në rastin e marrëveshjes së çmimit në avancë dypalëshe ose shumëpalëshe, marrëveshja anulohet vetëm në përputhje me dispozitat e marrëveshjes arritur mes autoriteteve kompetente.

20. Revokimi

20.1 DPT-ja mund të revokojë një marrëveshje të njëanshme të çmimit në avancë kur:

Ka pasur një shtrembërim, gabim ose mosveprim që është pasojë e neglizhencës, pakujdesisë, ose mospagim i qëllimshëm i tatimpaguesit kur ka plotësuar aplikimin, gjatë negocimeve të marrëveshjes, ose në përputhje me raportimin dhe kërkesat.

20.2 Efekti i revokimit sjell pasoja të atilla sikur marrëveshja të mos ketë ekzistuar asnjëherë.

20.3 Në rastin e një marrëveshjeje çmimi në avancë dypalëshe ose shumëpalëshe, marrëveshja revokohet vetëm në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së arritur ndërmjet autoriteteve kompetente.

21. Rinovimi

21.1 Dorëzimi i një aplikimi për të kërkuar rinovimin e një marrëveshjeje të çmimit në avancë duhet të ndjekë të njëjtat procedura të paraqitura në paragrafët 9-15 të këtij udhëzimi.

21.2 Ndërsa në praktikë termat dhe kushtet e Marrëveshjes së mëparshme të Çmimit në Avancë do të jenë influencuese kundrejt negocimit të rinovimit, termat dhe kushtet e pranuara në marrëveshjen e mëparshme të çmimit në avancë janë pa paragjykim për rinovimin

22. Konfidencialiteti

22.1 Në përputhje me nenin 25 "Konfidencialiteti", të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, informacioni i paraqitur nga tatimpaguesi gjatë takimit para dorëzimit, në aplikim, gjatë negocimit dhe në marrëveshjen përfundimtare është konfidenciale dhe duhet të përfaqësojë një sekret tatimor. Megjithatë, DPT-ja rezervon të drejtën e dhënies së informacionit statistikor publik mbi baza anonime siç kërkohet për plotësimin e "Raportit vjetor të programit të MÇA-së" (shiko paragrafin 23).

22.2 Në lidhje me MÇA-në dypalëshe ose shumëpalëshe, dispozita e shkëmbimit të informacionit të konventës përkatëse tatimore aplikohet në shkëmbimin e informacionit për qëllimet e dispozitave të MÇA-së. Kështu ruhet konfidencialiteti i informacionit i shkëmbyer për qëllimet e MÇA-së.

23. Raporti vjetor i programit të MÇA-së

23.1 DPT-ja, është e detyruar të përgatisë dhe të japë një raport vjetor mbi programin e Marrëveshjes së Çmimit në Avancë.

23.2 Raporti vjetor duhet të specifikojë për vitin zbatues:

- Numrin dhe llojin e aplikimeve të pranuara të Marrëveshjes së Çmimit në Avancë, të evidentuar sipas llojit të marrëveshjes dhe rinovimeve;
- numrin e aplikimeve të pranuara dhe të refuzuara, të evidentuara sipas llojit të marrëveshjes dhe rinovimit;
- tarifat totale të aplikimeve të arkëtuara dhe rimbursuara;
- numrin e të hyra në fuqi dhe numrin në pritje (nënnegocim), të evidentuara sipas llojit të marrëveshjeve dhe rinovimeve;
- periudhën mesatare kohore nga pranimi i aplikimit deri të arritja e marrëveshjes, të evidentuara sipas llojit të marrëveshjes;
- numrin e MÇA-ve të ripara, revokuara apo anuluara, të evidentuara sipas llojit të marrëveshjes dhe rinovimeve;
- numri i marrëveshjeve të hyra në fuqi, apo të rinovuara, sipas klasifikimit të industrisë së tatimpaguesit;
- numrin e marrëveshjeve të hyra në fuqi, ose të rinovuara, sipas llojit të transaksioneve të mbuluara;
- numrin e marrëveshjeve të hyra në fuqi ose të rinovuara, sipas metodës së pranuar të transferimit të çmimit;
- numrin e marrëveshjeve të hyra në fuqi gjatë vitit me secilin partner të konventës tatimore.

24. Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

SHTOJCA 1: PËRMBLEDHJA E PRITSHMËRIVE RECIPROKE

A1.1 Tatimpaguesit kërkojnë nga DPT-ja:

a) Të ndërmarrë një dialog të hapur dhe të vazhdueshëm me tatimpaguesin gjatë tërë procesit;

b) të punojë mbi fushën e marrëveshjes së çmimit në avancë dhe përqasjen e trajtimit për çdo çështje kolaterale kur është e nevojshme;

c) të kërkojë brenda transaksioneve të kontrolluara, metodologjinë e transferimit të çmimit dhe çmimit të pakontrolluar;

d) të ndërmarrë një shqyrtim për kolateralet e lëshuara, nëse ka, dhe të kordinojë zgjidhjen e tyre;

e) të angazhohet për zbatimin e kushteve të rëna dakord në MÇA, të cilat ndryshohen vetëm në raste të jashtëzakonshme;

f) të ofrojë në kohën e duhur informacione mbi ecurinë e aplikimit të tatimpaguesit për një MÇA;

g) të punojë me tatimpaguesin për të rënë dakord mbi informacionin/dokumentacionin e kërkuar në përpunimin e MÇA-së;

h) të hartojë bashkërisht me tatimpaguesin një plan pune në lidhje me MÇA-në që të përmbajë një afat kohor dhe një plan veprimi të strukturuar;

i)të punojë në mënyrë aktive me partnerin(ët) në zhvillimin e një MÇA-je dypalëshe/shumëpalëshe;

j) të ketë të drejtën e tërheqjes nga procesi i MÇA-së në çdo kohë përpara nënshkrimit të marrëveshjes përfundimtare të çmimit në avancë.

k) të ruajë informacionin konfidencial në përputhje me dispozitat mbi fshehtësinë e nenit 25 "Konfidencialiteti" dhe dispozitës së shkëmbimit të informacionit në konventën (ose konventat) tatimore përkatëse; dhe

l) të zbatojë procesin e MÇA-së në mënyrë të vazhdueshme dhe të shpejtojë procesin e MÇA-së, në mënyrë që ta lidhë atë me procesin e partnerëve të tjerë të konventës tatimore në MÇA-të dypalëshe/shumëpalëshe.

A1.2 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund të kërkojë nga tatimpaguesi:

a) Të bashkëpunojë plotësisht me DPT gjatë të gjithë procesit;

b) t'i sigurojë informacionin DPT në kohën e duhur;

c) të propozojë përqasjet të cilat janë në përputhje me nenin 2(4), nenet: 36-36/7 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" dhe udhëzimit nr. 16, datë 18.6.2014 "Për transferimin e çmimit";

d) të kërkojë një MÇA vetëm për transaksionet e kontrolluara të cilat janë aktuale dhe të vazhdueshme për nga natyra;

e) të paraqesë plotësisht dhe realisht të gjitha faktet materiale përkatëse në lidhje me transaksionet e kontrolluara dhe çështjet e tjera, nëse ka;

f) të punojë me DPT drejt arritjes së marrëveshjes në fushën e MÇA-së dhe trajtimin e çështjeve të tjera, nëse ka;

g) të paraqesë çdo pozicion/qëndrim të kërkuar në mënyrë të arsyeshme në lidhje me transaksionet e kontrolluara dhe çështjet e tjera, nëse ka;

h) të ofrojë të njëjtin informacion / dokumentacion te të gjithë partnerët e konventave tatimore të cilat janë palët e propozuara në MÇA-në, dypalëshe /shumëpalëshe;

i) të sigurojë informacionin/dokumentacionin konform kompleksitetit të marrëveshjes dhe nivelin e rrezikut; dhe

j) të ketë të drejtën për t'u tërhequr nga procesi i MÇA-së në çdo kohë para nënshkrimit të marrëveshjes përfundimtare të MÇA-së.

SHTOJCA 2: PYETËSORI PARADORËZIMI

Për të kërkuar një takim paradorëzimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Ju lutemi plotësoni formularin e mëposhtëm dhe e dërgoni atë me shkresë zyrtare në adresën: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, rruga "Gjin Bue Shpata", Tiranë.

Për më shumë informacion mbi dërgimin e paradorëzimit, lutemi shihni paragrafin 10 të këtij udhëzimi.

Informacion i përgjithshëm

1. Data e sotme:_____

2. Emri i tatimpaguesit shqiptar (ose anonim):

3. Numri i regjistrimit të tatimpaguesit (përveçse kur është anonim):

4. Emri i përfaqësuesit të tatimpaguesit dhe informacioni i kontaktit:

5. Afatet e kërkuara të MÇA-së (vitet fiskale 20____/___ deri 20/____/____):

6. Lloji i MÇA-së kërkuar: ☐ Njëanshme ☐ Dypalëshe ☐ Shumëpalëshe ☐

7. Vendi(et) kryesor/e të huaja të përfshira në transaksionin(et) e mbuluara nga MÇA-ja:

8. MÇA fillestare ☐ MÇA e rinovuar.

Transaksionet e mbuluara të propozuara

9. Përshkrimi i transaksionit(eve) të mbuluar;

10. Shuma e transaksionit të mbuluar (përcakto llojin e monedhës);

11. Përshkrim i shkurtër i industrisë/biznesit;

12. Metoda e propozuar e transferimit të çmimit;

13. Treguesi i propozuar i nivelit të fitimit dhe gama e tregut (ose pika);

14. Pala e testuar e propozuar.

Kërkesa e mbledhjes së paradorëzimit

15. Data e propozuar /koha për takimin e paradorëzimit të dosjes.

SHTOJCA 3: PËRMBAJTJET E APLIKIMIT TË KËRKUAR TË MÇA-SË; PLOTËSIMI I INFORMACIONIT

Lista e përmbajtjes së aplikimit të dhënë më poshtë nuk ka si synim të jetë shteruese, por më shumë është një listë orientuese në lidhje me informacionin e kërkuar për pranimin e aplikimit nga DPT-ja në përputhje me paragrafin 11.1 të këtij udhëzimi. Informacionet e mëtejshme mund të

kërkohen si pjesë e procesit të vlerësimit.

Saktësia e deklaratës

1. Tatimpaguesi duhet të përfshijë në çdo kërkesë për MÇA-në edhe dorëzimin suplementar të një deklarate në formën e mëposhtme:

Nën gjobat për dëshmi të rreme: Unë deklaroj se kam shqyrtuar këtë kërkesë të MÇA-së, [dorëzimin plotësues] lidhur me këtë kërkesë MÇA-je, duke përfshirë dokumente shoqëruese dhe me vetëdije dhe besimin e plotë, kërkesa për MÇA-në, [dorëzimi plotësues] përmban të gjitha faktet përkatëse lidhur me [kërkesën e MÇA-së], [dorëzimin plotësues] dhe këto fakte janë të vërteta, të sakta dhe të plota.

Deklarata duhet të nënshkruhet nga personi apo personat në emër të të cilëve është bërë kërkesa dhe jo nga përfaqësuesi i tatimpaguesit. Personi që nënshkruan në emër të një tatimpaguesi korporate duhet të jetë një zyrtar i autorizuar i tatimpaguesit, i cili ka njohuri personale të fakteve.

Përfaqësuesi i tatimpaguesit

2. Emri dhe informacioni i kontaktit për përfaqësuesin e tatimpaguesit për MÇA-në;

Ndërmarrjet e lidhura të përfshira në MÇA

3. Një deklaratë e emrave dhe adresave të të gjitha shoqërive apo palëve të MÇA-së;

4. Detajet e grupit të shoqërisë në të cilën shoqëria është anëtare, duke përfshirë detajet e strukturës së pronësisë (p.sh. një skemë të aksioneve/kuotave të pronësisë);

5. Detajet e bizneseve kryesore dhe të vendeve ku këto biznese veprojnë;

6. Konfirmimi nëse propozimi i MÇA-së është e njëanshme, dypalëshe apo shumëpalëshe dhe arsyet e përzgjedhjes;

7. Rezidenca tatimore e aplikantit, ndërmarrjeve të lidhura apo palëve që do të mbulohen nga MÇA-ja e propozuar dhe juridiksionet ose ndërmjet të cilave ato drejtojnë biznesin.

Afatet e MÇA-së

8. Vitet e propozuara për t'u mbuluar nga MÇA-ja.

Transaksionet e kontrolluara të mbuluara nga MÇA-ja

9. Një përshkrim i madhësisë, natyrës ose karakterizimit dhe vlera e transaksioneve të kontrolluara, të mbuluara nga MÇA-ja;

10. Një informacion i përgjithshëm mbi çdo transaksion tjetër të kontrolluar që nuk ka synim të mbulohet nga MÇA-ja;

11. Përshkrimet e marrëveshjeve kyçe ndërmjet shoqërive të lidhura;

12. Detajet e çfarëdo marrëveshjeje ose praktika të rëndësishme të transferimit të çmimit.

Analizat funksionale

13. Një përshkrim i biznesit të ndërmarrjes.

14. Hollësitë e funksioneve të rëndësishme ekonomike që kryhen nga secila palë e transaksioneve të kontrolluara të mbuluara nga MÇA-ja, asetet e përdorura në këto transaksione dhe rrezikun e supozuar, duke u fokusuar në faktorët kyç për realizimin e këtyre transaksioneve të kontrolluara.

Analizat e industrisë

15. Një përshkrim të industrisë dhe të tregut në të cilën vepron shoqëria.

16. Një shpjegim i pozicionit të shoqërisë në industri, duke përfshirë një listë të konkurrentëve kryesorë.

Përzgjedhja dhe aplikimi i metodologjisë së transferimit të çmimit

17. Një përshkrim të metodës së propozuar të transferimit të çmimit dhe arsyet se përse ajo metodë është më e përshtatshme.

18. Një shpjegim të metodës së transferimit të çmimit, e cila përdoret aktualisht për të testuar apo vendosur transferimin e çmimit të transaksioneve të kontrolluara, të mbuluara. Nëse është përdorur një metodë e panjohur, pohoni metodën e përdorur për vendosjen e çmimeve të tyre.

19. Një përshkrim të treguesve të nivelit më të përshtatshëm të fitimit dhe arsyet e përzgjedhjes së këtyre treguesve, kur është e nevojshme.

20. Të dhëna të mjaftueshme për të aplikuar metodologjinë e transferimit të çmimit dhe për të demonstruar se rezultati i arritur është brenda parimit të tregut.

21. Burimi i propozuar i të dhënave të krahasueshme dhe karakteristikat kyçe ose kriteret që duhet të plotësohen nga çdo transaksion i pakontrolluar në mënyrë që të konsiderohet potencialisht i krahasueshëm.

22. Një përshkrim të krahasueshmërive të propozuara dhe një analizë e faktorëve kyç të krahasueshmërisë ndërmjet palës së krahasueshme dhe të testuar.

23. Detaje dhe llogaritje të çdo rregullimi të propozuar të rezultateve të krahasueshme.

24. Rezultati i propozuar i tregut apo diapazoni që rezulton nga aplikimi i metodologjisë së transferimit të çmimit.

25. Rezultatet e parashikuara nga zbatimi i metodologjisë së propozuar (duke përfshirë analizat e ndjeshmërisë) gjatë afatit të MÇA-së.

26. Procesi nëpërmjet të cilit çdo rregullim i nevojshëm i rezultateve aktuale të shoqërisë mund të bëhet gjatë MÇA-së (rregullime kompensuese)

Të tjera

Pozicioni financiar dhe tatimor i të gjitha shoqërive të lidhura të përfshira në MÇA-në për së paku 3 vitet e fundit, duke përfshirë: shitjet, koston e mallrave të shitur, shpenzimet operative, fitimin para tatimeve, asetet, detyrimet, numrin e punonjësve dhe çdo të dhënë tjetër.

Informacion mbi projeksionet/buxhetimet financiare gjatë periudhës së MÇA-së.

Një përshkrim të çdo ngjarjeje kritike të veprimtarisë së sipërmarrjes së biznesit dhe aftësia e tij për të arritur rezultatet e parashikuara sipas MÇA-së së propozuar (d.m.th. supozime kritike).

Kërkesa shtesë për marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe të çmimit në avancë.

Marrëveshja dhe deklarata

Unë bie dakord që të gjitha dokumentet dhe informacionet e dorëzuara në DPT për qëllim aplikimin të MÇA-së, mund t'i jepen autoritetit/ve kompetente të partnerëve të konventës tatimore përkatëse për procedimin e MÇA-së. Gjithashtu unë marr përsipër dërgimin e dokumenteve dhe informacioneve të njëjta autoritetit kompetent të partnerit/ve të konventës tatimore sipas kërkesave të tyre. Deklaroj se kam shqyrtuar aplikimin, përfshirë dokumentet shoqëruese, dhe me dijeninë time të plotë dhe me besimin se, faktet e paraqitura për aplikimin tim janë të vërteta, të plota dhe të sakta.

Emri i shoqërisë shqiptare:_____

Nënshkrimi i zyrtarit kryesor:_____

Emri dhe titulli i zyrtarit kryesor:_____

Informacioni i plotësimit të aplikimit

1. Tarifa (shoqëruar me një letër identifikuese, e cila përmban justifikimin e shumës së tarifës së paguar) duhet të dërgohet në :_____

[Adresa postare _____]

2. Përmbajtja e aplikimit dhe informacioni shtesë i MÇA-së duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme:_____

[Adresa e caktuar]

*Lutemi kini parasysh se mund të kërkohen kopje shtesë të aplikimit të MÇA-së nëse nevojiten.

SHTOJCA 4: RAPORTI VJETOR I PAJTUESHMËRISË

Në përputhje me këtë udhëzim të Marrëveshjeve të Çmimit në Avancë (MÇA) në Shqipëri, tatimpaguesi shqiptar do të dorëzojë raportin vjetor të përputhshmërisë së mëposhtme si pjesë shtojcë me deklarimin vjetor të tatimit të të ardhurave.

Seksioni I: Informacioni përmbledhës i MÇA-së

16. Emri i tatimpaguesit, Shqipëri:

17. Numri i regjistrimit të tatimpaguesit:

18. Emri i përfaqësuesit të tatimpaguesit dhe informacioni i kontaktit; kontaktet:;_____

19. Afati i MÇA-së (vitet e tatueshme 20_/__/__/ deri 20__/___/):

20. Kjo përmbledhja e Raportit Vjetor është për Vitin tatimor që përfundon:

21.Lloji i MÇA-së: ☐ Njëanshme ☐ Dypalëshe Shumëpalëshe ☐

22. Vend(et) kryesore të huaja të përfshira në transaksionin(et) e mbuluara të MÇA-së:

23. MÇA fillestare ☐MÇA e rinovuar ☐

24. A ka pasur ndryshime ose amendime kjo MÇA? ☐ PO ☐ JO ☐ Nëse Po, Data:

25. A ka respektuar tatimpaguesi shqiptar afatet dhe kushtet e gjithë MÇA?☐Po ☐ Jo ☐

26. A ka shkaktuar tatimpaguesi shqiptar ndonjë supozim kritik të detajuar në MÇA?

Jo ☐ Po ☐ (Nëse Po, bashkëngjisni deklaratën shtesë të shpjeguar)

27. A ka rregullime kompensuese të kërkuara sipas kushteve të MÇA-së?

Jo ☐ Po ☐(Nëse Po, bashkëngjisni deklaratën shtesë me shpjegimin e rregullimit kompensues dhe ku rregullimi kompensues reflektohet në kthimin e tatimit mbi të ardhurat)

28. A ka ndonjë dallim material mes veprimtarisë

të biznesit të tatimpaguesit shqiptar (duke përfshirë funksionet, rreziqet e supozuara, tregjet, kushtet kontraktuale, kushtet ekonomike, pasurisë, shërbimeve dhe aseteve të përdorura) gjatë vitit aktual të MÇA-së nga veprimtaritë e biznesit të përshkruar në kërkesën e MÇA-së?

☐ Jo ☐ Po ☐ (Nëse po, bashkëngjisni deklaratën shtesë të shpjeguar)

29. A ka ndryshime materiale në metodat financiare dhe kontabël të llogaritjes së tatimit ose parimeve kontabël të përdorura për vitin e MÇA-së në lidhje me transaksionet e mbuluara, të cilat ndryshojnë nga metodat financiare dhe kontabël të llogaritjes së tatimit të përdorur në kërkesën e MÇA?

☐ Jo ☐ Po ☐ (Nëse po, bashkëngjisni deklaratën shtesë të shpjeguar)

Seksioni II: Metoda e transferimit të çmimit

30. Pala e testuar e MÇA: ☐ Tatimpaguesi shqiptar ☐ i huaj ☐ Të dyja

31. Testimet e MÇA-së (kontrollo të gjitha që zbatohen): Baza vjetore ☐ Baza disa vjetore Baza afatgjatë ☐

32. MÇA mundëson (shëno të gjitha që zbatohen): Norma pikë ☐ Vetëm dysheme Vetëm tavan ☐Tjetër (lutemi specifikoni): ☐

33. MÇA përcakton rregullime (shëno të gjitha që zbatohen):Kufirin më të afërt ☐ Mesatar pikë tjetër (lutemi specifikoni): ☐

Seksioni III: Informacion shtesë i pajtueshmërisë së MÇA-së

Lutemi jepni informacionin shtesë si më poshtë vijon për të demonstruar përputhshmërinë me MÇA-së të referuar më lart:

1. Një deklaratë të shkurtër e cila demonstron se si shoqëria shqiptare ka synuar në mënyrë aktive transferimin e çmimit të pranuar si pjesë të MÇA-së.

2. Informacionin dhe përllogaritjet e nevojshme për të konstatuar përfundimin e MÇA-së për transaksionet e mbuluara ndërmjet tatimpaguesit shqiptar dhe palëve të lidhura. Kjo përfshin demonstrimin e shkallës së pajtueshmërisë së afateve dhe kushteve të MÇA-së.

3. Zërat shtesë që mund të jenë të përshtatshëm në rrethana specifike të tatimpaguesit shqiptar që ka të bëjë me MÇA-në e referuar.

DPT-ja do të rishikojë raportin vjetor të pajtueshmërisë dhe nëse është e nevojshme, mund të kërkojë informacione të mëtejshme që janë të nevojshme në mënyrë të arsyeshme për të vërtetuar se tatimpaguesi shqiptar i referuar në këtë raport vjetor të MÇA-së ka plotësuar në përputhje me afatet dhe kushtet e MÇA-së.

Nëse tatimpaguesi shqiptar nuk ofron raportin vjetor të pajtueshmërisë ose furnizimin me informacion shtesë të kërkuar sipas paragrafit 19 të këtij udhëzimi, DPT-ja mund të anulojë MÇA-në.

UDHËZIM
Nr. 1283, datë 16.2.2015

PËR MËNYRËN E EKZEKUTIMIT TË DETYRIMEVE MONETARE TË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES NË LLOGARI TË THESARIT

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 589 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe neneve 43 dhe 54 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

UDHËZON:

1. Ky udhëzim ka si qëllim përcaktimin e mënyrës së ekzekutimit, nga llogaria e thesarit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes së detyrimeve monetare që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë.

2. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore realizohet nga Drejtoria e Financës:

a) Me fondet buxhetore, të akorduara në ligjin vjetor të buxhetit përkatës, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

3. Drejtoria e Financës çdo vit parashikon fonde buxhetore të planifikuara për shpenzimet, që do të kryejë institucioni, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

4. Në rastin kur Drejtoria e Financës do të bëjë ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nga ana e përmbaruesit gjyqësor, duhet të jetë depozituar ky dokumentacion:

i) Dokumenti që vërteton njoftimin e njësisë shpenzuese debitore, për ekzekutimin vullnetar dhe të detyruar të detyrimit dhe marrjen dijeni nga ana e tij;

ii) vendimin gjyqësor, i cili në kuptim të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, konsiderohet si titull ekzekutiv;

iii) kërkesën /urdhrin e zyrës përmbarimore, për vendosjen e masës së sekuestros. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose i noterizuar, apo i vërtetuar "njësia me origjinalin", nga sekretaria e gjykatës.

5. Drejtoria e Financës, brenda 5 (pesë) ditëve, i kërkon degës së thesarit pagesën e shumës së detyrimit nga llogaria e parashikuar, në këtë udhëzim.

6. Në rastet kur Drejtoria e Financës, me fondet buxhetore që ka në dispozicion, nuk është në gjendje të shlyejë as një pjesë të detyrimit sipas vendimit gjyqësor, në bazë të nenit 517 të Kodit të Procedurës Civile, kërkon nga Drejtoria e Shërbimeve Juridike t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për shlyerjen pjesore të detyrimit me fondet e vitit / viteve në vijim, duke bërë edhe njoftimin përkatës, pranë përmbaruesit gjyqësor.

7. Në rast pranimi, nga ana e gjykatës, të kërkesës për ekzekutimin e pjesshëm të vendimit, njësia shpenzuese paraqet një kopje të vendimit të gjykatës në Degën e Thesarit, e cila merr masa dhe e regjistron si angazhim buxhetor të njësisë shpenzuese, të detyrueshëm për t'u zbatuar.

8. Drejtoria e Financës, me përparësi në vitet e ardhshme, planifikon fondet e nevojshme për shlyerjen e këtyre detyrimeve të mbartura, duke ndjekur procedurat përkatëse të planifikimit të fondeve buxhetore, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

9. Në shlyerjen e vendimeve gjyqësore nga ana e Drejtorisë së Financës, duhet t'i jepet përparësi shlyerjes së detyrimeve të mëparshme.

Në asnjë rast, nuk mund të vendoset masa e sekuestros mbi të ardhurat në burim të buxhetit të shtetit, pasi ato nuk janë fonde buxhetore të njësisë debitore.

10. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Degët e Thesarit dhe Përmbaruesit Gjyqësor, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 9, datë 25.2 2015

PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTET NË VAZHDIM PËR SHËNDETËSINË, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE PËR VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr.160, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte në vazhdim, me cikël financimi 2014-2015, për nënprogramin e shëndetësisë, në vlerën 22 600 000 (njëzet e dy milionë e gjashtëqind mijë) lekë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, specifikuar sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri Shëndetësisë, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi, pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Anëtar;
Ministri i Financave	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	Anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	Anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar;
Ministri i Kulturës	Anëtar;
Ministri i Mjedisit	Anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	Anëtar.

Tabela 1. Projektet në vazhdim, në nënprogramin e Shëndetësisë, me cikël financimi 2014-2015

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (lekë)	Realizimi 2014	Vlera e financimit për vitin 2015 (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (lekë)
Qarku Lushnjë						
1	Bashkia Divjakë	Ndërtimi i Qendrës Shëndetësore, Divjakë	52,400,000	-	22,600,000	29,800,000
		Totali	**52,400,000**	**-**	**22,600,000**	**29,800,000**

Shënim.

1. "Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga NJQV-të).

2. "Vlera e financimit për vitin 2015" tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015.

3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2015 do të financohet nga FZHR-ja për vitin 2016.

VENDIM
Nr. 13, datë 11.2.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË " DRAGOBIA ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2 germa "a", 9 ; 45 pika 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neni 4, pika 1, germa "f"; neni 5 pika 1 germa "f" dhe neni 12, 13 dhe neni 14 pika 1, "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008. Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Dragobia Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Dragobia Energy" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është i plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar.

Dokumentacioni teknik:

- Neni 9, pika 4/9, germa "a" e plotësuar.
- Neni 9, pika 4/9, germa "b" e plotësuar.
- Neni 9, pika 4/9, germa "c" e plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Dragobia Energi" sh.p.k., për aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komsionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 14, datë 11.2.2015

MBI KËRKESËN E OST SHA PËR RISHIKIMIN DHE PEZULLIMIN E VENDIMIT NR. 156, DATË 1.12.2014 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S "PËR MIRATIMIN RREGULLAVE TË ANKANDIT TË ZYRËS SË KOORDINUAR TË ANKANDEVE PËR EVROPËN JUGLINDORE (SEE CAO)"

Mbështetur në nenin 9, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neni 23 pika 1, dhe nenit 111, 113, germa e ligjit nr. 8485, datë 12.5.2008 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neni 16, pika 3 "Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s", miratuar me vendim nr. 21 datë 18.3.09, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për rishikimin dhe pezullimin e vendimit nr. 156 datë 1.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Për miratimin e rregullave të ankandit të zyrës së koordinuar të ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO)" si dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike,

konstatoi se:

- Ministria e Financave ka miratuar udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, ku përjashtohet aplikimi i TVSH-së për faturën për të drejtën e përdorimit të kapaciteteve të interkonjeksionit të Zyrës së Koordinuar për Evropën Juglindore.

- Vendimi nr. 156, datë 1.12.2014 i Bordit të Komisionerëve të ERE-s nuk mund të zbatohet për ankandet e kapaciteteve me vendet kufitare që nuk kanë implementuar Rregullat e Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO).

- Po ashtu ligji nr. 8485, datë 12.5.2008 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, në nenin 111 "Rregulla të përgjithshme", përcakton se: "Aktet administrative hyjnë në fuqi nga dita e miratimit të tyre me përjashtim të rasteve kur ligji ose vetë akti i jep atij fuqi prapavepruese ose të vonuar."

- Ligji nr. 8485, datë 12.5.2008 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, në nenin 113 përcakton se: "Aktet administrative kanë efekt të vonuar: c) kur hyrja në fuqi e aktit varet nga vërtetimi i disa kushteve ose rrethanave."

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Rishikimin e vendimit nr. 156, datë 1.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Miratimin e Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO)", si më poshtë:

- Pas pikës 2, shtohet pika 3 me përmbajtjen:

Për ankandet e kapaciteteve të interkonjeksionit me vendet kufitare që nuk kanë implementuar "Rregullat e Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO)", OST sh.a, do zbatojë vendimin nr. 140, datë 22.11.2013 të Bordit të Komisionerëve "Për miratimin e rregullores së alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit", të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 15, datë 11.2.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË "GAEA-ENERGJIA ALTERNATIVE E GJELBËR" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3 pika 35 ,8 germa "a"; 9 dhe 13 pika 1, germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neni 4, pika 1, germa "g"; 8, neni 10 pika 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Gaea-Energjia Alternative e Gjelbër" sh.p.k., si dhe

relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "GAEA-Energjia Alternative e Gjelbër" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është i plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar në gjuhën greke. Sipas nenit 8 pika 3 dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën shqipe.

- Neni 9, pika 4/10, germa "a" e plotësuar.
- Neni 9, pika 4/10, germa "b" e paplotësuar.
- Neni 9, pika 4/10, germa "c" e plotësuar.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "GAEA-Energjia Alternative e Gjelbër" sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komsionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 16, datë 11.2.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË "GAEA-ENERGJIA ALTERNATIVE E GJELBËR" SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3 pika 31; 8 pika 2, germa "a"; 9 dhe nenit 45 pika 4, dhe 48 pika 2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neni 4, pika 1, germa "f"; 5 pika 1 germa "f"; dhe 8, neni 10 pika 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, neni 18 pika 1 germa "a" të "Rregullave e Praktikës dhe Procedurave të ERE-s" me vendim nr. 21 datë 18.3.2009, i ndryshuar. Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "GAEA- Energjia e Energjisë Elektrike" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "GAEA-Energjia Alternative e Gjelbër" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është i plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar në gjuhën greke. Sipas nenit 8 pika 3 dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën shqipe.

Dokumentacioni teknik:

- Neni 9, pika 4/9, germa "a" e plotësuar.
- Neni 9, pika 4/9, germa "b" e paplotësuar.
- Neni 9, pika 4/9, germa "c" e plotësuar.
- Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "GAEA-Energjia Alternative e Gjelbër" sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komsionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 17, datë 11.2.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "POWER ELEKTRIK SLLABINJE" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a"; 9 dhe 13 pika 1, germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "g"; 5 pika 2; 8 dhe 13 dhe 14 pika 1 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Power Elektrik Sllabinje" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Power Elektrik Sllabinje" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10 germat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Power Elektrik Sllabinje" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 25-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 18, datë 11.2.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "POWER ELEKTRIK SLLABINJE" SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, germa "a"; 9 dhe nenit 45 pika 4 dhe 48 pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "f"; 5 pika 1 germa "f"; 13 dhe 14 pika 1, të "Rregullores për procedurat e licencimit,

modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Power Elektrik Sllabinje" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi Licencimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Power Elektrik Sllabinje" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat "a", "b", "c") janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Power Elektrik Sllabinje" sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komsionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 19, datë 11.2.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HIDROPOWER ELEKTRIK" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a"; 9 dhe 13 pika 1, germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "g"; 5 pika 2; 8 dhe 13 dhe 14 pika 1 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Hidropower Elektrik" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hidropower Elektrik" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në " Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit ", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10 germat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Hidropower Elektrik" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 26- vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për

vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 20, datë 11.2.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HIDROPOWER ELEKTRIK" SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, germa "a"; 9 dhe nenit 45 pika "4" dhe 48 pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "f"; 5 pika 1 germa "f"; 13 dhe 14 pika 1, të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Hidropower Elektrik" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi Licencimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Hidropower Elektrik" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat "a", "b", "c") janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Hidropower Elektrik" sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 21, datë 11.2.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "FATLUM" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a"; 9 dhe 13 pika 1, germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "g"; 5 pika 2; 8 dhe 13 dhe 14 pika 1 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Fatlum" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për Licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Fatlum" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10 germat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Fatlum" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 22, datë 11.2.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË "GREEN ENERGY TRADING ALBANIA" SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3 pika 35, 8 pika 1 germa "a" 9 dhe 13 pika 1 germa "d", të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neni 4, pika 1, germa "g"; neni 8, 10 pika 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Green Energy Trading Albania" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Green Energy Trading Albania" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa "a" e plotësuar.
- Neni 9, pika 4/10, germa "b" e plotësuar.
- Neni 9, pika 4/10, germa "c" e plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Green Energy Trading Albania" sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 23, datë 11.2.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "FUTURE ENERGY AL" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a"; 9 dhe 13 pika 1, germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "g"; 5 pika 2; 8 dhe 13 dhe 14 pika 1 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen

e tij të datës 11.2.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Future Energy AL" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Future Energy AL" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10 germat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Future Energy AL" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 24, datë 11.2.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "FUTURE ENERGY AL" SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, germa "a"; 9 dhe nenit 45 pika 4 dhe 48 pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "f"; 5 pika 1 germa "f"; 13 dhe 14 pika 1, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Future Energy AL" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi Licencimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Future Energy AL" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e Licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të Licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat "a", "b", "c") janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Future Energy AL" sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 25, datë 11.2.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ANIO OIL & GAS" SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR PËR NJË AFAT 5-VJEÇAR

Në mbështetje të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror", neni 14, pika 1, germa "ç", si dhe neni 4, pika 1, germa "ç"; neni 8, neni 9 pika 1, germa "a", "b", "c", "d", "e"; pika 2, germa "e" dhe nenin 10 pika 1 dhe pika 11 të "Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror," miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 11.2. 2011; Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Anio Oil & Gas" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Anio Oil & Gas" sh.a., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE:

- Dokumentacioni i përgjithshëm;

Nenin 9, pika 1 , germa ("a", "b", "c") (Formati i aplikimit plotësuar në mënyre korrekte) dhe neni 9, pika 1, germa ("d/i", "d/ii") (Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor) është plotësuar në mënyre korrekte.

- Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale;

Neni 9, pika 1, germa "e/V" (Pagesës së aplikimit në ERE), neni 9, pika 1, germa "e/VI" (Plan biznesi), neni 9, pika 1, germa "e/ i" (Sigurimet shoqërore dhe tatim taksat), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Anio Oil & Gas" sh.a. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 26, datë 11.2.2015

PËR MIRATIMIN E PAGESËS SË APLIKIMIT PËR LICENCË NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 10 të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror", nenit 8 pika 2 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë dhe të pjesshëm dhe rinovimit të licencave në sektorin e gazit natyror", miratuar me vendimin nr. 9, datë 11.2.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015 mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore Administrim-Financës dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit mbi përcaktimin e pagesës së aplikimit për licencë në sektorin e gazit natyror dhe konsideroi të drejtë interpretimin e Drejtorive,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e pagesës së aplikimit për licencë në aktivitetin e furnizimit dhe tregtimit në sektorin e gazit natyror, të njëjtë me pagesat e aplikimit të të licencuarve në aktivitetin e furnizimit dhe tregtimit në sektorin e energjisë elektrike siç janë përcaktuar në aneksin A të "Rregullore për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë dhe të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", miratuar me vendimin nr. 108 datë 9.9.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 27, datë 16.2.2015

MBI MIRATIMIN E TARIFËS FIKSE TË ENERGJISË, PËR VITIN 2015, QË DO T'U PAGUHET PRODHUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 15, pika 3, të ligjit nr. 138/2013 "Për burimet e energjisë së rinovueshme", të ndryshuar, nenit 111, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.2008 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 11.2.2015 "Për miratimin e metodologjisë të përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, për vitin 2015, që do t'u paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet"; Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar; Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.2.2015, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve mbi tarifën fikse të shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e energjisë elektrike për vitin 2015,

VENDOSI:

1. Tarifa fikse e energjisë elektrike, që do t'i paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2015, do të jetë 7.636 lekë/kWh.

2. Vendimi nr. 5, datë 26.1.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes se energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW", dhe vendimi nr. 24, datë 11.4.2007, i Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e reja me fuqi të instaluar deri në 10 MW" shfuqizohen.

3. Ngarkohet KESH sh.a. dhe prodhuesit e energjisë elektrike nga hidrocentralet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga 1.1.2015 deri më 31.12.2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Shtetasi Llazi Sema, i biri i Markos dhe i Dafinës, i datëlindjes 3.10.1944, lindur në Ferras dhe banues në Fier, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier shpalljen të vdekur të djalit të tij Leonard Sema.

KËRKUESI
Llazi Sema

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 245 lekë